

V E N D I M
Nr.435, datë 11.6.2001

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE TË OBJEKTEVE TË
KTHYERA NË BANESA ME FONDET E NDËRMARRJES
SË DUHAN-CIGAREVE, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe të nenit 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.2001 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në pronësi të Entit Kombëtar të Banesave të objekteve, magazinave, të kthyer në banesa me fondet e Ndërmarrjes së Duhan-cigareve, Durrës. Enti Kombëtar i Banesave të kryejë privatizimin e tyre, sipas akteve ligjore në fuqi, në favor të familjeve që banojnë aty dhe sipas listave të hartuara nga ndërmarja dhe të miratuara nga Këshilli Bashkiak, Durrës.

2. Enti Kombëtar i Banesave të bëjë llogaritjen e vlerës së privatizimit të këtyre banesave. Të ardhurat nga ky privatizim t’i derdhen Degës së Sigurimeve Shoqërore në Durrës, për llogari të Ndërmarrjes së Duhan-cigareve, Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta